

V E N D I M
Nr.220, datë 10.5.1999

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 79, DATË 11.2.1999, "PËR RUAJTJEN DHE SHOQËRIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE DHE TRAJTIMIN ME PAGË TË EFEKTIVAVE TË KËTYRE SHËRBIMEVE"

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 7602, datë 9.9.1992 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 79, datë 11.2.1999, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 2, pas fjalëve "zëvendëskryeministrit", shtohen fjalët "Kryetari i Gjykatës Kushtetuese".
2. Në pikën 3, pas fjalëve "ministrit të Financave" shtohen fjalët "Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit".
3. Në pikën 6, në paragrafin e tretë pas fjalëve "Anëtarëve të Këshillit të Ministrave", shtohen fjalët "Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit". Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko